



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 378, Datë 28.12.2023**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E “RREGULLORES PËR  
LËSHIMIN, TRANSFERIMIN, TËRHEQJEN DHE ANULIMIN E GARANCIVE TË  
ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E  
RINOVUESHME”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; ”, neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2330/3 prot., datë 26.12.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”,

**Konstatohet se:**

- Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019 është hartuar në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.
- Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64, datë 14.04.2023, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas këtij botimi.
- Në nenin 22, pika 2 e këtij ligji përcaktohet se: ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe siguron përafrimin e politikave dhe parimeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë.
- Po ashtu, në nenin 22, pika 14 e këtij ligji është parashikuar se: *ERE duhet t’i bashkohet sistemit rajonal të komunitetit të energjisë për të mundësuar tregtimin e garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë.*

- Ky detyrim është përmbushur nga ERE me nënshkrimin e marrëveshjes për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.
- Në nenin 22, pika 1, të këtij ligji përcaktohet, ndër të tjera, se: *ERE-ja miraton rregullat për lëshimin e garancive të origjinës dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të garancive të origjinës.*
- Në zbatim të këtij përcaktimi është draftuar “Rregullorja për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.
- Në hartimin e kësaj rregulloreje janë marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, specifikat e sistemit rajonal të garancive të origjinës dhe elementet e regjistrit elektronik të GO-ve.
- Rregullorja përbëhet nga 26 nene, të cilat përcaktojnë kryesisht kërkesat dhe procedurat e ndjekura për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, në përputhje me regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancive të origjinës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e *“Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”*.
2. Grupi i punës, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund ti kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari**  
**Petrit Ahmeti**